



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**PROJEKTLIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-040 PËR  
VETËQEVERISJEN LOKALE<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON SUPPLEMENTING AND AMENDING THE LAW NO. 03 / L-040 ON LOCAL  
SELF-GOVERNMENT<sup>2</sup>**

**NACRTA ZAKONA O IZMENAMA I DOPUNAMA ZAKONA BR. 03/L-040 O LOKALNOJ  
SAMOUPRAVI<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, është miratuar në mbledhjen e 47 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 07/47, Datë, 10.12.2021

<sup>2</sup> Draft Law on Supplementing and Amending the Law No. 03 / L-040 on Local Self-government, was approved on the 47 meeting of the Government of the Republic Kosovo, with the Decision No. 07/47 Date, 10.12.2021.

<sup>3</sup> Nacrtu Zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, usvojen je na 47 sednicu Vlade Republika Kosova, sa Odlukom Br. 07/47, Datum, 10.12.2021.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L- 040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (G.Z. e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iii / nr. 28 / 04 qershor 2008), në tekstin e mëtejshëm - ligji.</p>	<p>The Assembly of Republic of Kosova, Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Hereby adopt;</p> <p><b>DRAFT LAW ON SUPPLEMENTING AND AMENDING THE LAW NO. 03 / L-040 ON LOCAL SELF- GOVERNMENT</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>This law aims to amend supplement the Law No. 03/L-040 on Local Self-government (Official Gazettee of the Republic of Kosovo / Prishtine: year iii / no. 28 / 04 June 2008), here in after the - law.</p>	<p>Skupština Republike Kosovo U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja;</p> <p><b>NACRTA ZAKONA O IZMENAMA I DOPUNAMA ZAKONA BR. 03/L-040 O LOKALNOJ SAMOUPRAVI</b></p> <p><b>Član 1 Cilj</b></p> <p>Ovaj zakon ima za cilj izmenu i dopunu Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi (S.G Republike Kosovo / Priština: godina iii / br. 28/04. Jun 2008), u daljem tekstu-zakon.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b></p> <p>Neni 2 paragrafi 2 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si ne vijim: 2.2 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale zbatohet edhe për Komunën e Prishtinës, përveç nëse parashihet ndryshe në Ligjin për Kryeqytetin.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b></p> <p>Article 2 paragraph 2 of the base law is amended and reformulated as follows: 2.2 Law on Local Self-government is implemented also in the municipality of Prishtina, unless otherwise provided in the Law on Capital.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b></p> <p>Član 2 stav 2 osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku: 2.2 Zakon o lokalnoj samoupravi primenjuje se i za opštinu Priština, osim ako je zakonom o glavnom gradu drugačije određeno.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>Neni 3 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim: Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p><b>“Kartë”</b>- nënkupton Karta evropiane mbi vetëqeverisjen lokale, e miratuar nga Këshilli i Evropës me 15 Tetor 1985;</p> <p><b>“Komunitet”</b> – nënkupton përkufizimin sipas ligjit perkatës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;</p> <p><b>“Qeveria”</b>- nënkupton Qeveria e Republikës së Kosovës;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b></p> <p>Article 3 of basic law is amended and reformulated as follows: The expressions used in this law have the following meaning:</p> <p><b>“Charter,”</b>- shall mean the European Charter of Local Self-Government, as adopted by the Council of Europe on the 15th of October 1985 ;</p> <p><b>“Community,”</b>- shall mean as defined in the relevant law for the protection and promotion of the rights of communities and their members in the Republic of Kosovo;</p> <p><b>“Government,”</b>- shall mean the Government of Republic of Kosova;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b></p> <p>Član 3 osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku: Izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju sledeća značenja:</p> <p><b>„Povelja”</b> podrazumeva Evropsku povelju o lokalnoj samoupravi usvojenu od strane Saveta Evrope 15. oktobra 1985. godine;</p> <p><b>"Zajednica"</b> - podrazumeva definiciju prema relevantnom zakonu o zaštiti i promovisanju prava zajednica i njihovih pripadnika u Republici Kosovo;</p> <p><b>"Vlada"</b> podrazumeva Vladu Republike Kosova;</p>

<p><b>“Qytetar”</b> - nënkupton shtetas i Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në Ligjin për Shtetësinë e Kosovës;</p> <p><b>“Vetëqeverisje lokale”</b>- nënkupton e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale që, brenda kufizimeve ligjore, të rregullojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të qytetarëve;</p> <p><b>“Komunë”</b>- nënkupton njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës;</p> <p><b>“Kuvendi i Komunës”</b>- nënkupton organin më të lartë të komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta;</p> <p><b>“Kryetari”</b>- nënkupton organin më të lartë ekzekutiv i komunës që zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta;</p> <p><b>“Kryesuesi i Kuvendit”</b>- nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e Kuvendit të Komunës i cili përfaqëson kuvendin, thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës;</p> <p><b>Fjala ‘komunale’</b> në tërë tekstin e këtij ligji zëvendësohet më shprehjen</p>	<p><b>“Citizen”</b>- shall mean the citizen of the Republic of Kosovo, as defined in the Law on Statehood of Kosovo;</p> <p><b>“Local Self-government”</b>- shall mean the right and ability of local authorities that within the legal limits, to regulate and manage a substantial share of public affairs under their own responsibility and in the interest of the local population;</p> <p><b>“Municipality”</b>- shall mean the basic territorial unit of local self-government in Republic of Kosovo;</p> <p><b>“Municipal Assembly”</b>- is the highest representative body of the municipality consisting of all its elected members in direct elections;</p> <p><b>“Mayor”</b>- is the highest executive body of the municipality elected through direct elections;</p> <p><b>“Chairman of the Assembly”</b>- shall mean the Chairman elected by the members of the municipal assembly, who represents the assembly, calls and chairs the meetings of the municipal assembly;</p> <p><b>- Word ‘municipal’</b> throughout the text of this law is replaced by the expression</p>	<p><b>"Građanin"</b> - podrazumeva državljanin Republike Kosovo, kako je definisano u Zakonu o državljanstvu Kosova;</p> <p><b>"Lokalna samouprava"</b> - podrazumeva pravo i sposobnost lokalnih vlasti, u zakonskim granicama, da uređuju i upravljaju značajnim delom javnih poslova pod njihovom odgovornošću i u interesu građana;</p> <p><b>"Opština"</b> - podrazumeva osnovnu teritorijalnu jedinicu lokalne samouprave u Republici Kosovo;</p> <p><b>„Skupština opštine“</b> - podrazumeva najviši organ opštine koji se sastoji od njenih članova izabranih na neposrednim izborima;</p> <p><b>„Gradonačelnik“</b> - podrazumeva najviši izvršni organ opštine koji se bira neposrednim izborima;</p> <p><b>"Predsedavajući Skupštine"</b> - podrazumeva predsedavajućeg koga biraju odbornici Skupštine opštine koji predstavlja skupštinu, saziva i predsedava sednicama Skupštine opštine;</p> <p><b>Reč „opštinsko“</b> u celom tekstu ovog zakona zamenjuje se izrazom „opštine“, kada se koristi u kontekstu opštine;</p>
---	--	---

<p>‘komunës’, kur përdoret në kontekstin e komunës;</p> <p><b>“Parimi i subsidiaritetit”</b>- nënkupton që çështjet publike të realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në interes të qytetarëve nga niveli më i ulët i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase;</p> <p><b>“Kompetencat vetanake”</b>- nënkupton kompetencat që u jepen komunave me kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin;</p> <p><b>“Kompetencat e deleguara”</b>- nënkupton kompetencat e qeverisë qendrore dhe të institucioneve të tjera qendrore ekzekutimi i të cilave komunave përkohësisht u caktohet me ligj;</p> <p><b>“Kompetencat e zgjeruara”</b>- nënkupton kompetencat që u jepen me ligj një komune, apo një numri komunash;</p> <p><b>“Rishikimi administrativ”</b>- nënkupton të drejtën dhe kompetencat e institucioneve të qeverisë qendrore për ta rishikuar ligjshmërinë e autoriteteve lokale në fushën e kompetencave të zgjeruara dhe ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e</p>	<p>‘municipality’, when used in the context of the municipality;</p> <p><b>“Principle of Subsidiary”</b>- means that the public affairs shall be dealt with as closely as possible to the interest of citizens of the municipality by the lowest level of government that is able to provide public services efficiently;</p> <p><b>“Own competencies”</b>- shall mean competencies vested upon the municipalities by the Constitution or laws for which they are fully responsible in insofar as they concern the local interest and in accordance with the law;</p> <p><b>“Delegated Competencies”</b>- shall mean competencies of the central government and other central institutions the execution of which is temporarily assigned by law to municipalities;</p> <p><b>“Enhanced competencies”</b>- shall mean competencies vested upon a municipality or a number of municipalities by law;</p> <p><b>“Administrative Review”</b>- is the right and competences of central government institutions to review the legality of the activity of the local authorities in the area of own and enhanced competencies and the legality and expediency of their</p>	<p><b>„Naçelo supsidijarnosti“</b> - podrazumeva da se javni poslovi vrše, što je više moguće, u interesu građana od strane najnižeg nivoa uprave koji je u mogućnosti da pruža efikasne usluge;</p> <p><b>„Sopstvene nadležnosti“</b> - podrazumevaju nadležnosti date opštinama ustavom ili zakonom za koje su one u potpunosti odgovorne u smislu lokalnog interesa, ili u skladu sa zakonom;</p> <p><b>"Delegirane nadležnosti"</b> - podrazumeva nadležnosti centralne vlade i drugih centralnih institucija, čije izvršenje je zakonom privremeno dodeljeno opštinama;</p> <p><b>"Proširene nadležnosti"</b> - podrazumevaju nadležnosti koje su zakonom date opštini ili određenom broju opština;</p> <p><b>"Administrativno razmatranje"</b> - podrazumeva pravo i nadležnosti institucija centralne vlade da preispituju zakonitost lokalnih vlasti u oblasti proširenih nadležnosti i zakonitost i adekvatnost</p>
--	--	--

<p>aktiviteteve të tyre në fushën e kompetencave të deleguara;</p> <p><b>“Organi mbikqyrës”</b>- nënkupton ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale dhe/ose institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në fushat e tyre përkatëse të përgjegjesisë;</p> <p><b>“Mbikëqyrja e ligjshmërisë”</b>- nënkupton rishikimin e realizuar nga organi mbikëqyrës, për t’u siguruar se aktet komunale janë nxjerrë në pajtim me dispozitat e zbatueshme ligjore dhe se organi që i ka nxjerrë nuk ka vepruar në tejkalim të mandatit të tij ligjor;</p> <p><b>“Mbikëqyrja e përshtatshmërisë”</b>- nënkupton rishikimin e bërë nga organi mbikëqyrës, për t’u siguruar se kompetencat e deleguara janë ekzekutuar në përputhje me rregullat, kriteret dhe standardet e përcaktuara nga qeveria qendrore dhe për t’u siguruar se masat e marra nga komuna kanë qenë relevante për arritjen e objektivave dhe rezultateve të caktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;</p> <p><b>“Votim i shumicës”</b>- nënkupton votimin për të cilin kërkohet miratimi nga më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në mbledhjen në të cilën</p>	<p>activity in the area of delegated competencies;</p> <p><b>“Supervisory authority”</b>- shall mean the ministry responsible for the local government and/or other institutions of the Government of Republic of Kosova in their respective areas of responsibility;</p> <p><b>“Review of legality”</b>- shall mean the review conducted by the supervisory authority to ensure that municipal acts have been issued in conformity with applicable legal provisions and that the issuing body has not acted in excess of its legally recognized mandate;</p> <p><b>“Review of expediency”</b>- shall mean the review conducted by the supervisory authority to ensure that delegated competencies have been executed in compliance with the rules, criteria and standards determined by the central government and if the measures taken by municipality were appropriate to achieve the objectives and results determined by the Government of Republic of Kosova;</p> <p><b>“Majority vote”</b>- shall mean a vote that requires the assent of more than one half of the members present and voting at the meeting at which the proposal is</p>	<p>njihovih aktivnosti u oblasti delegiranih nadležnosti;</p> <p><b>"Nadzorno telo"</b> - podrazumeva ministarstvo nadležno za lokalnu samoupravu i / ili druge institucije Vlade Republike Kosovo, u njihovim oblastima odgovornosti;</p> <p><b>"Nadzor zakonitosti"</b> – podrazumeva razmatranje koji vrši nadzorno telo, kako bi se osiguralo da su opštinski akti izdati u skladu sa važećim zakonskim odredbama i da telo koje ih je izdalo nije postupilo preko svog zakonskog mandata;</p> <p><b>"Nadgledanje uskladenosti"</b> - podrazumeva razmatranje koje je izvršilo nadzorno telo, kako bi se osiguralo da su delegirana ovlašćenja izvršena u skladu sa pravilima, kriterijumima i standardima koje je postavila centralna vlada i kako bi se osiguralo da su mere koje su preduzele opštine relevantne za postizanje ciljeva i rezultata koje je postavila Vlada Republike Kosovo;</p> <p><b>„Većinsko glasanje”</b> podrazumeva glasanje koje zahteva pristanak više od polovine prisutnih odbornika kojiglasaju na sastanku ili sednici na kojoj se razmatra</p>
---	--	---

<p>shqyrtohet propozimi. Ky është një mekanizëm përmes të cilit duhet të merren vendimet e kuvendit të komunës;</p> <p><b>“Shumica prej dy të tretave (2/3)”</b>- nënkupton votimin që kërkon miratimin nga dy të tretat (2/3) e të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës;</p> <p><b>“Ministria”</b>- nënkupton ministrinë përgjegjëse për qeverisjen lokale, nëse konteksti qartazi nuk nënkuptohet ndryshe;</p> <p><b>“Statuti i komunës”</b>- nënkupton aktin më të lartë juridik i komunës, që miratohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullon organizimin e brendshëm të komunës;</p> <p><b>“Rregullorja e punës”</b>- nënkupton aktin që miratohet nga kuvendi i komunës që parashikon rregullat e rendit dhe të mirësjelljes;</p> <p><b>“Rregullore komunale”</b>- nënkupton aktin nënligjor të Komunës që miratohet nga kuvendi i komunës dhe rregullon çështje të caktuara në kuadër të kompetencave të komunës.</p>	<p>considered. This is the default mechanism by which decisions of Municipal Assembly shall be brought;</p> <p>“</p> <p><b>Two thirds (2/3) majority</b>”- shall mean a vote that requires the assent of 2/3 of all the members of the Municipal Assembly;</p> <p><b>“Ministry”</b>- shall mean the ministry responsible for local government unless the context clearly refers otherwise;</p> <p><b>“Statute of the Municipality,”</b>- shall mean the highest act adopted by the municipal assembly in accordance with the legislation in force of the Republic of Kosovo and which shall regulate the internal organization of the municipality;</p> <p><b>“Rule of Procedure”</b>- shall mean an act adopted by the municipal assembly providing the rules of order and conduct;</p> <p><b>“Municipal regulation”</b>- shall mean a bylaw of the municipality adopted by the municipal assembly regulating certain issues within the competencies of the municipality.</p>	<p>predlog. Ovo je standardni mehanizam na osnovu koga će Skupština opštine donositi odluke;</p> <p><b>„Dvotrećinska većina (2/3)“</b> “ podrazumeva glasanje koje zahteva pristanak dve trećine (2/3) ukupnog broj odbornika Skupštine opštine;</p> <p><b>„Ministarstvo“</b> “ podrazumeva ministarstvo koje je odgovorno za lokalnu samoupravu, osim ako kontekst rečenice jasno ne podrazumeva nešto drugo;</p> <p>- <b>“Statut opštine”</b> - podrazumeva najviši pravni akt opštine koji usvaja Skupština opštine u skladu sa važećim zakonodavstvom Republike Kosovo i uređuje unutrašnju organizaciju opštine;</p> <p><b>„Poslovnik o radu”</b> podrazumeva usvojen akt u Skupštini opštine kojim se regulišu pravila reda, ponašanja;</p> <p>- <b>“Opštinska uredba”</b> - podrazumeva podzakonski akt opštine koji je odobren od strane skupštine opštine i uređuje određena pitanja iz nadležnosti opštine.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b></p> <p>1. Neni 4 paragrafi 1 në Ligjin bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p>4.1. Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga qytetarët në një territor të caktuar, themelimi i së cilës, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj rregullohen me ligj, dhe e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.</p> <p>2. Neni 4 paragrafi 6 në Ligjin bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p>4.6 Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të tyre për t'u ofruar qytetarëve shërbime më afër, në pajtim me nenin 34 të këtij ligji dhe statuteve të tyre.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b></p> <p>1. Article 4 paragraph 1 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p>4.1. The municipality is the basic unit of local self-government in Republic of Kosovo, made up of community of citizens of a specific territory, the establishment of which, its borders, competencies and the way of its organization and functioning are regulated by law, and shall exercise all powers which are not explicitly reserved for the central institutions.</p> <p>2. Article 4 paragraph 6 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p>4.6 Municipalities have the right to enter into agreements with villages, quarter or settlements within their territory to offer services closer to citizens in accordance with Article 34 of this law and their statutes.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4</b></p> <p>1. Član 4 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p> <p>4.1. Opština je osnovna jedinica lokalne samouprave u Republici Kosovo, sastavljena od građana na određenoj teritoriji, čije je uspostavljanje, njene granice, nadležnosti i način njenog organizovanja i funkcionisanja regulisani zakonom, i koja vrši svu moć koja nije izričito rezervisana za centralne institucije.</p> <p>2. Član 4 stav 6 Osnovnog zakona menja se i reformuliše kao u nastavku:</p> <p>4.6 Opštine imaju pravo da zaključe sporazume sa selima, naseljima ili prebivalištima na svojoj teritoriji radi bližeg pružanja usluga građanima, u skladu sa članom 34. ovog zakona i njihovim statutima.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b></p> <p>1. Neni 7 paragrafi 1 në ligjin bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p>7.1. Komunat përdorin simbolet e tyre, stemat, vulat, emblemat dhe flamujt e komunës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b></p> <p>1. Article 7 paragraph 1 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p>7.1. Municipalities shall use their own symbols including the coats of arms, seals, emblems, and municipal flags.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b></p> <p>1. Član 7 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p> <p>7.1. Opštine koriste sopstvene simbole, grbove, pečate, ambleme i zastave opština.</p>



<p>2. Neni 7 paragrafi 4 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim: 7.4. Simbolet e komunave miratohen dhe ndryshohen me dy të tretën (2/3) e votimit të kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.</p>	<p>2. Article 7 paragraph 4 of the base law is amended and reformulated as follows: 7.4. The symbols of a municipality may be approved or changed by two thirds (2/3) majority vote of the municipal assembly after extensive public consultation has taken place.</p>	<p>2. Član 7 stav 4 Osnovnog zakona menja se i reformuliše kao u nastavku: 7.4. Simboli opštine mogu biti usvojeni i promenjeni dvotrećinskom (2/3) većini glasanja Skupštine opštine, uz pretodno sveobuhvatnih javnih konsultacija.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b></p>
<p>Tek Neni 11 i ligjit bazik shtohet paragraf i ri si në vijim:</p>	<p>A paragraph is added to Article 11 of the base law as follows:</p>	<p>Članu 11 osnovnog zakona dodaje se novi stav:</p>
<p>11.2 Ministria me akt nënligjor rregullon procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës..</p>	<p>11.2 Ministry with a sub-legal act regulates the procedure of drafting and publication of municipal acts.</p>	<p>11.2 Ministarstvo podzakonskim aktom uređuje postupak izrade i objavljivanja opštinskih akata.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b></p>
<p>Neni 12 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>Article 12 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>Član 12 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>12.1 Kuvendi i komunës miraton akte brenda fushës së kompetencave të tij.</p>	<p>12.1 The municipal assembly may adopt acts within the scope of its competences.</p>	<p>12.1 Skupština opštine usvoja akte u okviru svojih nadležnosti.</p>
<p>12.2 Aktet e kuvendit të komunës vlejné në territorin e komunës që ka miratuar aktin.</p>	<p>12.2 Acts of the municipal assembly are valid in the territory of the municipality that has adopted the act.</p>	<p>12.2 Akti Skupštine opštine važe na teritoriji opštine koja je ove akte usvojila.</p>
<p>Këto akte përfshijnë: a) statutin e komunës;</p>	<p>These acts shall include: a) Statute of the Municipality;</p>	<p>Ovi akti obuhvataju: a) statut opštine</p>

<p>b) rregulloren e punës;  c) rregulloret komunës;  d) vendimet;  e) dokumentet e politikave, përfshirë aktet e planifikimit hapësinor;  f) dokumentet strategjike të Komunës;  g) marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit; si dhe  h) akte tjera për funksionim efikas të komunës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>8.1. Neni 14 paragrafi 1 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p>14.1. Komunat kanë të drejtë të kenë në pronësi dhe të menaxhojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.</p> <p>8.2. Neni 14 paragrafi 3 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p>14.3. Komunat mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe pronësi të tyre.</p>	<p>b) Rules of Procedure;  c) Municipal regulations;  d) decisions;  e) policy documents, including the spatial planning acts;  f) strategic documents of the municipality;  g) different cooperation agreements; as well as  h) other acts for the efficient operation of the municipality.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p>8.1. Article 14 paragraph 1 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p>14.1. Municipalities have the right to own and manage movable and immovable property.</p> <p>8.2. Article 14 paragraph 3 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p>14.3. Municipalities shall keep and maintain the register of all movable and immovable property used or owned by the municipality.</p>	<p>b) poslovnik rada;  c) opštinske uredbe;  d) odluke;  e) dokumenti politike, uključujući akte prostornog planiranja;  f) strateške dokumente opština;  g) različite ugovore o saradnji, kao i  h) druge akte za efikasno funkcionisanje opštine.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p>8.1. Član 14 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p> <p>14.1. Opštine imaju pravo da poseduju i upravljaju svojom pokretnom i nepokretnom imovinom.</p> <p>8.2. Član 14 stav 3 Osnovnog zakona menja se i reformuliše kao u nastavku:</p> <p>14.3. Opštine vode i održavaju spisak pokretne i nepokretne imovine koju opština poseduje ili koristi.</p>
--	---	--

<b>Neni 9</b>	<b>Article 9</b>	<b>Član 9</b>
<p>Neni 17 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>Article 17 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>Član 17 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Kompetencat vetanake</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Own competencies</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Sopstvene nadležnosti</b></p>
<p>Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijnë:</p>	<p>Municipalities shall have full and exclusive powers, insofar as they concern the local interest, while respecting the standards set forth in the applicable legislation in the following areas:</p>	<p>Opština ima potpunu i isključivu nadležnost u pogledu lokalnih interesa, poštujući pri tom standarde predviđene važećim zakonodavstvom u sledećim oblastima:</p>
<p>a) zhvillimin ekonomik lokal; b) planifikimin urban dhe rural; c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin; d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; e) mbrojtjen e mjedisit lokal; f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes publike lokale, si dhe ndërmarrjen e veprimeve të lidhura me sigurinë në bashkësi; g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale; h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë</p>	<p>a) local economic development; b) urban and rural planning; c) land use and development; d) implementation of building regulations and building control standards; e) local environmental protection; f) provision and maintenance of public services and utilities, including water supply, sewers and drains, sewage treatment, waste management, local roads, local transport, and local heating schemes, as well as undertaking actions related to community safety; g) response to local emergency cases; h) provision of public pre-primary, primary and secondary education, including registration and licensing of educational institutions, recruitment,</p>	<p>a) lokalni ekonomski razvoj; b) urbano i ruralno planiranje; c) korišćenje zemljišta i razvoj; d) sprovođenje građevinskih propisa i standarda za kontrolu građenja; e) zaštita lokalne životne sredine; f) pružanje i održavanje javnih i komunalnih usluga, uključujući snabdevanje vodom, kanalizaciju i odvodnju, prečišćavanje otpadnih voda, upravljanje otpadom, lokalni putevi, lokalni transport i lokalno javno grejanje, kao i preduzimanje radnji u vezi sa bezbednošću u zajednici; g) odazivanje u hitnim lokalnim slučajevima; h) pružanje javnog predškolskog, osnovnog i srednjeg obrazovanja, uključujući</p>

<p>regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;</p> <p>i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut</p> <p>j) shëndetësinë publike në nivelin primar shëndetësor;</p> <p>k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të rrezikuarit, banimin social, përkujdesin ndaj fëmijëve, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e pagave dhe trainimin e profesionistëve të mirëqenies sociale.</p> <p>l) Ofrimin e shërbimeve për objektet publike dhe në banimin kolektiv.</p> <p>m) mbrojtjen e shëndetit publik lokal;</p> <p>n) dhënie e lejeve për ofrimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik dhe taksitë, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;</p> <p>o) emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;</p> <p>p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;</p> <p>q) turizmin lokal;</p>	<p>payment of salaries and training of education instructors and administrators;</p> <p>i) promotion and protection of human rights;</p> <p>j) provision of public primary health care;</p> <p>k) provision of family and other social welfare services, such as care for the vulnerable, foster care, child care, elderly care, including registration and licensing of these care centres, recruitment, payment of salaries and training of social welfare professionals;</p> <p>l) provision of services for public buildings and collective housing;</p> <p>m) protection of local public health;</p> <p>n) issuing permits for the provision of public services and facilities, including those related to entertainment, cultural and leisure activities, food, lodging, markets, street vendors, local public transportation and taxis, as well as supervising their implementation;</p> <p>o) naming of roads, streets and other public places;</p> <p>p) provision and maintenance of public parks and spaces;</p> <p>q) local tourism;</p> <p>r) cultural and leisure activities;</p> <p>s) care and welfare of animals, local public cementeries; and</p> <p>sh) any matter which is not explicitly excluded from their competence nor assigned to any other authority.</p>	<p>registraciju i licenciranje obrazovnih institucija, zapošljavanje, isplate plata i obuke instruktora obrazovanja i administratora;</p> <p>i) promocija i zaštita ljudskih prava;</p> <p>j) pružanje javne primarne zdravstvene zaštite;</p> <p>k) pružanje porodičnih i drugih usluga socijalne zaštite, kao što su briga o ugroženima, socijalno stanovanje, briga o deci, briga o starima, uključujući registraciju ovih centara za brigu, zapošljavanje, isplatu plata i obuku socijalnih stručnjaka.</p> <p>l) Pružanje usluga za javne zgrade i kolektivno stanovanje;</p> <p>m) zaštita lokalnog javnog zdravlja;</p> <p>n) izdavanje dozvola za pružanje javnih usluga i objekata, uključujući one koje se odnose na zabavu, kulturne i zabavne aktivnosti, hranu, stanovanje, tržnice, ulične prodavce, lokalni javni prevoz i taksi, kao i nadzor nad njihovom primenom;</p> <p>o) imenovanje ulica, uličica i drugih javnih mesta;</p> <p>p) obezbeđivanje i održavanje parkova i javnog prostora;</p> <p>q) lokalni turizam;</p> <p>r) slobodne I kulturne aktivnosti;</p> <p>s) briga i dobrobit životinja, lokalno javno groblje; kao i</p>
---	--	---

<p>r) aktivitetet kulturore dhe të lira; s) kujdesi dhe mirëqenia për kafshët, varrezat publike lokale; si dhe sh) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër. Për mënyren e ofrimit të shërbimeve për qytetar ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale nxjerr akt nënligjor</p>	<p>The ministry responsible for local self-government issues a sub-legal act on the manner of providing services to citizens.</p>	<p>sh) svako pitanje koje nije izričito isključeno iz njihove nadležnosti ili koje nije dodeljeno drugom organu. Ministarstvo nadležno za poslove lokalne samouprave donosi podzakonski akt o načinu pružanja usluga građanima.</p>
<p><b>Neni 10</b></p>	<p><b>Article 10</b></p>	<p><b>Član 10</b></p>
<p>10.1. Neni 24 paragrafi 1 në ligjin bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>10.1. Article 24 paragraph 1 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>10.1. Član 24 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>24.1. Komunat kanë buxhetet e tyre për financimin e kompetencave të tyre.</p>	<p>24.1. Municipalities have their own budgets to finance their competencies</p>	<p>24.1. Opštine imaju sopstvene budžete za finansiranje svojih nadležnosti.</p>
<p>10.2. Neni 24 paragrafi 3 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>10.2. Article 24 paragraph 3 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>10.2. Član 24 stav 3 Osnovnog zakona menja se i reformuliše kao u nastavku:</p>
<p>24.3 Financimi i komunave rregullohet me Ligjin për financa të pushtetit lokal.</p>	<p>24.3 The financing of municipalities is regulated by the Law on Local Government Finance.</p>	<p>24.3 Finansiranje opština regulisano je Zakonom o finansijama lokalne uprave.</p>
<p><b>Neni 11</b></p>	<p><b>Article 11</b></p>	<p><b>Član 11</b></p>
<p>11.1. Neni 25 paragrafi 1 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>11.1. Article 25 paragraph 1 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>11.1. Član 25 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>25.1 Shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet publike të komunës.</p>	<p>25.1 Municipal utilities are provided by municipal public enterprises. Public</p>	<p>25.1 Komunalne usluge obezbeđuju opštinska javna preduzeća. Javna</p>

<p>Ndërmarrjet publike funksionojnë sipas legjislacionit përkatës për ndërmarrjet publike.</p> <p>11.2. Pas paragrafit 1 të Nenit 25 shtohet një paragraf i ri 1A si në vijim:</p> <p>25.1A. Komunat kanë të drejtë të themelojnë Ndërmarrje Publike lokale, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>enterprises operate according to the relevant legislation on public enterprises.</p> <p>11.2. After paragraph 1 of the Article 25 is added a new paragraph 1A as follows:</p> <p>25.1A. Municipalities have the right to establish local public enterprises, in accordance with the legislation in force.</p>	<p>preduzeća posluju u skladu sa relevantnim zakonima o javnim preduzećima.</p> <p>11.2. Posle stava 1 člana 25 dodaje se novi stav 1A koji glasi:</p> <p>25.1A. Opštine imaju pravo da osnuju lokalna javna preduzeća, u skladu sa zakonodavstvom na snazi.</p>
<p><b>Neni 12</b></p>	<p><b>Article 12</b></p>	<p><b>Član 12</b></p>
<p>Neni 26 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>Article 26 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>Član 26 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>26.1 Komunat obligohen të bëjnë auditimin e brendshëm sipas Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike.</p> <p>26.2 Komunat themelojnë njësitë e auditimit te brendshëm ne përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin e brendshëm të financave publike.</p>	<p>26.1 Municipalities are obliged to conduct internal audit based on the Law on Internal Control of Public Finances.</p> <p>26.2 Municipalities establish internal audit units in accordance with the criteria set out in the legislation in force for internal control of public finances.</p>	<p>26.1 Opštine su dužne da vrše internu reviziju u skladu sa Zakonom o unutrašnjoj kontroli javnih finansija.</p> <p>26.2 Opštine osnivaju jedinice za unutrašnju reviziju u skladu sa kriterijumima utvrđenim zakonodavstvom na snazi za unutrašnju kontrolu javnih finansija.</p>
<p><b>Neni 13</b></p>	<p><b>Article 13</b></p>	<p><b>Član 13</b></p>
<p>Neni 27 paragrafi 1 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>Article 27 paragraph 1 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>Član 27 stav 1 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>27.1 Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës bën auditimin e</p>	<p>27.1 The National Audit Office of the Republic of Kosova shall perform external</p>	<p>27.1 Nacionalna kancelarija za reviziju Republike Kosovo vrši spoljnu reviziju u</p>

<p>jashtëm në çdo komunë në baza vjetore sipas legjislacionit përkatës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b></p> <p>Neni 34 paragrafi 3 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p>34.3 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale nxjerr akt nënligjor lidhur me marrëveshjet ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve.</p>	<p>audits of each municipality on annual basis according to the relevant legislation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b></p> <p>Article 34 paragraph 3 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p>34.3 The ministry responsible for the local government shall issue sub-legal act regarding the arrangements between the municipality and villages, settlements and urban quarters.</p>	<p>svakoj opštini na godišnjem nivou u skladu sa relevantnim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b></p> <p>Član 34 stav 3 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p> <p>34.3 Nadležno ministarstvo za lokalnu samoupravu donosi podzakonski akt u vezi sa sporazumima između opštine i sela, naselja i prebivališta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b></p> <p>Neni 35 i Ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Kuvendi i Komunës</b></p> <p>35.1 Kuvendi i komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.</p> <p>35.2 Të gjithë qytetarët e komunës kanë të drejtë të kandidohen në zgjedhjet për kuvendin e komunës, me kusht që ata t'i</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b></p> <p>Article 35 of the base law is amended and reformulated as follows:</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Municipal Assembly</b></p> <p>35.1 Municipal Assembly is the highest representative body of the municipality and shall be directly elected by the citizens in accordance with the Law on Local Elections.</p> <p>35.2 All citizens of the municipality have the right to run in the elections for the municipal assembly, provided that they</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b></p> <p>Član 35 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Skupština Opština</b></p> <p>35.1 Skupština opštine je najviši organ u opštini i neposredno je biraju građani u skladu sa Zakonom o lokalnim izborima.</p> <p>35.2 Svi građani opštine imaju pravo da se kandiduju na izborima za skupštinu opštine, pod uslovom da ispunjavaju uslove utvrđene Zakonom o lokalnim izborima.</p>

<p>plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin mbi zgjedhjet lokale.</p> <p>35.3 Mandati i çdo anëtari të kuvendit të komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtar.</p> <p>35.4 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:  “Beto hem se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime, e me ndërgjegje dhe sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës, detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i kuvendit të komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë më të mirë dhe të qetë për të gjithë”.</p> <p>35.5 Anëtarët e kuvendit të komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, humbin të drejtën të jenë anëtarë të kuvendit.</p>	<p>meet the conditions set out in the Law on Local Elections.</p> <p>35.3 The mandate of the each members of the municipal assembly shall be verified by a commission on verification of mandates established by the municipal assembly, before the signing of the mandate by each member.</p> <p>35.4 All members of the municipal assembly shall sign the following solemn oath or declaration of office:  “I swear (or solemnly declare) that I will perform my duties and exercise my powers as a member of the Municipal assembly of _____ municipality honorably, faithfully, impartially, conscientiously and according to the legislation in force in the Republic of Kosovo, so as to ensure conditions for a peaceful life for all citizens”.</p> <p>35.5 Members of the municipal assembly who fail to sign the oath in accordance with paragraph 4 of this Article, within one month of the certification of the election results, shall lose the right to be a member of the assembly.</p>	<p>35.3 Mandat odbornika Skupštine opštine mora biti potvrđen od strane komisije zadužene za verifikaciju mandata koju osniva Skupština opštine pre potpisivanja mandata svakog odbornika.</p> <p>35.4 Svi odbornici Skupštine opštine pojedinačno potpisuju sledeću svečanu zakletvu izjavu dužnosti:  “Kunem se da ću svoje dužnosti obavljati časno, verno, nepristrasno, savesno i u skladu sa zakonom na snazi u Republici Kosovo, i svoja ovlašćenja ću obavljati kao odbornik skupštine opštine _____, na način da se svima obezbede uslovi za bolji i mirniji život”.</p> <p>35.5 Odbornici skupštine opštine koji ne potpišu zakletvu u skladu sa stavom 4. ovog člana u roku od mesec dana od overe izbornih rezultata, gube pravo da budu članovi skupštine.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b></p>
<p>Neni 37 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si ne vijim:</p>	<p>Article 37 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>Član 37 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Term of Office of the members of the municipal assembly</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Mandat odbornika skupštine opštine</b></p>
<p>37.1 Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite.</p> <p>37.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar:</p> <p>37.2.1 me rastin e përfundimit të mandatit të tij;</p> <p>37.2.2 nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;</p> <p>37.2.3 nëse anëtari ia paraqet kryesuesit të kuvendit dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;</p> <p>37.2.4 nëse anëtari dënohet për ndonjë vepër penale me vendim të formës së prerë me burgim për gjashtë (6) ose më shumë muaj;</p> <p>37.2.5 nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.</p>	<p>37.1 The term of office of members of the municipal assembly shall be four years.</p> <p>37.2 A member of the municipal assembly shall cease to be a member:</p> <p>37.2.1 at the expiration of the member's term of office;</p> <p>37.2.2 if he/she changes the residence where he/she is elected;</p> <p>37.2.3 upon the submission of a written resignation of his post to the mayor of the municipality;</p> <p>37.2.4 if a member is convicted of a criminal offence by a final decision of imprisonment for six (6) months or more;</p> <p>37.2.5 if this law, or other laws in force, disqualifies or deems ineligible the member.</p>	<p>37.1 Mandat odbornika u skupštini opštine traje četiri godine.</p> <p>37.2 Odbornik u skupštini opštine prestaje da bude član:</p> <p>37.2.1 po isteku odborničkog mandata;</p> <p>37.2.2 ako on/ona promeni prebivalište gde je izabran;</p> <p>37.2.3 ako odbornik pismeno podnese ostavku predsedavajućem skupštine;</p> <p>37.2.4 ako je odbornik pravosnažno osuđen za krivično delo na kaznu zatvora u trajanju od šest (6) meseci ili više;</p> <p>37.2.5 ako važeći zakon ili bilo koji drugi primenljivi zakon diskvalifikuje ili smatra da je neprihvatljiv.</p>

<p>37.2.6 nëse nuk merr pjesë në mbledhje të kuvendit komunal për një periudhë kohore prej gjashtë muajsh pa arsye;</p> <p>37.3 Kuvendi i Komunës themelon komision ad hoc për hartimin e raportit përfundimtar lidhur me plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>37.4 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>37.2.6. ako bez razloga ne prisustvuje sednici skupštine opštine u periodu od šest meseci;</p> <p>37.3 The municipal assembly establishes an ad hoc commission for drafting the final report regarding the fulfillment of the conditions set in paragraph 2 of this Article.</p> <p>37.4 A member of a municipal assembly may not simultaneously hold a position of a member of the assembly of Republic of Kosova.</p>	<p>37.2.6 if he/she does not participate in the meeting of the municipal assembly for a period of six months without reason;</p> <p>37.3 Skupština opštine osniva ad hoc komisiju za izradu završnog izveštaja o ispunjenosti uslova iz stava 2. ovog člana.</p> <p>37.4 Odbornik skupštine opštine ne može istovremeno biti i poslanik u Skupštini Republike Kosovo.</p>
<p><b>Neni 17</b></p>	<p><b>Article 17</b></p>	<p><b>Član 17</b></p>
<p>Neni 39 paragrafi 2 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>Article 39 paragraph 2 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>Član 39 stav 2 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>39.2. Anëtari i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet e komunës nga kryetari, drejtorët e drejtorive të komunës, apo nga kryesuesi i komitetit përkatës. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.</p>	<p>39.2. A member of the municipal assembly may request information concerning municipal matters from the mayor, directors of municipal directorates or the Chairman of a relevant committee. The request shall be dealt with in accordance with procedures to be set out in the Statute and Rules of Procedure.</p>	<p>39.2. Odbornik u skupštini opštine ima pravo da traži informacije o opštinskim pitanjima od gradonačelnika, direktora opštinskih uprava ili od predsednika nadležne komisije. Zahtev se razmatra u skladu sa procedurama utvrđenim Statutom i Poslovikom rada.</p>
<p>2. Neni 39 paragrafi 4 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:</p>	<p>2. Article 39 paragraph 4 of the base law is amended and reformulated as follows:</p>	<p>2. Član 39 stav 4 Osnovnog zakona menja se i reformuliše, kao u nastavku:</p>
<p>39.4. Anëtari i kuvendit të komunës mund të marrë pjesë në mbledhjet e cilit do</p>	<p>39.4. A member of the municipal assembly may address, but not vote at meetings of</p>	<p>39.4. Odbornik u skupštini opštine može učestvovati na sastancima bilo kog odbora</p>

